

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Dhjetor, 2021**

ETUCE dhe EPSU në mbrojtje të pavarësisë së sindikatave

Miliona sindikalistë nga Evropa në mbështetje të SBASHK-ut



Duke përcjellë me kujdes situatën aktuale në arsimin e Kosovës dhe angazhimet e vazhdueshme të SBASHK-ut për dialog e për zgjedhje të drejtë të kresave legjitimet të anëtarësisë dhe duke parë qëndrimet jo të drejta të Kryeministrit Kurti dhe deklaratimet e tij që janë përzierje e pa drejtë në pavarësinë dhe organizimin e sindikatave Kryetari i EUCE Larry Flanagan, drejtorja Evropiane e ETUCE-së Susan Flocken dhe sekretari i përgjithshëm i EPSU Jan Willem Goudriaan, i kishin dërguar më 9 dhjetor një letër të përbashkët Kryeministrit Kurti duke ia bërë me dije se vlerësojë lart angazhimin e SBASHK-ut dhe duke kërkuar që Kryeministri të nis dialogun e sinqertë dhe të heq dorë nga praktika e gabuar për përzierje në organizimin sindikalë dhe në të drejtën e patjetërsueshme të...(faqe 5)

SBASHK shembull i shkëlqyer i gatishmërisë për dialog

Takime me shefat e Grupeve Parlamentare kanë vazhduar

Me qëllim që t'i informojnë subjektet...(faqe 7)

U mbajt Kuvendi i Arsimit të Mesëm të Lartë

Viti 2021, vit zgjedhor i SBASHK-ut

Në sallën e takimeve në Qendrën e Studentëve më 14 dhjetor u mbajt Kuvendi i Arsimit të Mesëm të Lartë. Në mungesë...(faqe 9).

Në mbyllje të këtij viti të vështirë, por edhe me arritje të mëdha

Stafi i SBASHK-ut përshëndetje dhe mesazh për anëtarësinë

Stafi qendror i SBASHK-ut edhe gjatë gjithë vitit 2021 ishte në nivel të detyrës dhe bëri shumë angazhime për të realizuar...(faqe 3)

Në përmbyllje të agjendës së zgjedhjeve të brendshme në SBASHK

U mbajt Kuvendi i Arsimit Parafillor, Fillor e të Mesëm të Ulët

Duke vazhduar me realizimin e agjendës...(faqe 8)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Gëzuar me shpresën për ditë më të mira



SBASHK po përmbyll edhe këtë vit dhe në organet udhëheqëse janë bërë e po bëhen analiza të angazhimeve dhe arritjeve. Duke krahasuar planifikimet dhe realizimet e detyrave vlerësohet me të drejtë se edhe ky viti 2021 ishte vit i sfidave, por edhe i arritjeve të mëdha në SBASHK. Punuan me përkushtim Ymeri, Bardhi, Vjollca, Blendori dhe me përkushtim e në shumë takime me Komisionin e MASHTI-t u arrit të finalizohet versioni final dhe Arsimi i Kosovës ka Kontratën e re Kolektive. U bë punë e madhe edhe në organizimin e trajnimeve sipas vullnetit të anëtarësisë dhe u tejkalua edhe plani për këtë aktivitet me rëndësi sepse më shumë se 5000 kolege e kolegë nga komunat e Kosovës ishin pjesë e këtij aktiviteti . Ju lumtë Albinës, Ymerit, Vjollcës, Blendit,

Afërditës, Nezit e Vlorës. Ju lumtë edhe kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe trajnerëve për angazhimin dhe arritjet.

Ky vit na përballi edhe me sfida të tjera e me debate e përplasje me institucionet duke mbrojtur kërkesat legjitime të anëtarësisë. U dëshmuar edhe një herë uniteti dhe përkushtimi ynë në mbrojtje të kresave të anëtarësisë dhe në përfaqësimin e denjë të SBASHK-ut.

Përfaqësuesit tanë përfaqësuan në mënyrë të denjë SBASHK-un edhe në aktivitetet ndërkombëtare organizuar nga ETUCE dhe EI, të cilët ishin krah nesh dhe na mbështeten kurdo herë që e kërkonte nevoja. Ishim në nivel të detyrës edhe këtë vit dhe shumë nga aktivitetet do të rikujtohen në gazetën tonë “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2021”.

Rrugëtimin me plot arritje e suksese do të vazhdojmë bashkë e në SBASHK. Gëzuar.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Në mbyllje të këtij viti të vështirë, por edhe me arritje të mëdha

Stafi i SBASHK-ut përshëndetjet dhe mesazh për anëtarësinë

Stafi qendror i SBASHK-ut edhe gjatë gjithë vitit 2021 ishte në nivel të detyrës dhe bëri shumë angazhime për të realizuar kërkesat legjitime të anëtarësisë. Ky staf, duke mos shikuar as orarin e madje duke punuar edhe gjatë vikendeve, ka organizuar aktivitete të shumta nga të cilat do veçuar përgatitjen dhe mundësinë e pjesëmarrjes në trajnime të qindra grupeve të punëtorëve arsimor nga e tërë Kosova, bashkëbisedën me palët duke këshilluar e mbështetur ata në realizimin e të drejtave të punës dhe të atyre që sjell Kontrata Kolektive e Arsimit, përgatitja dhe organizimi i aktiviteteve tradicionale për pushimin e qindra kolegeve dhe kolegëve tanë nga e tërë Kosova në bregdetin shqiptar dhe shumë e shumë aktivitete të tjera. Ata me punë e përkushtim gëzojnë respektin dhe besimin e anëtarësisë dhe për këtë ndjehen krenar. Stafi qendror në këtë fundvit përshëndet dhe i drejtohet me mesazh anëtarësisë kudo janë.



Ymer Ymeri

Ishte ky një vit i vështirë e me plot sfida, por forcën për angazhime e arritje e kemi gjetur te ju anëtarësi e nderuar duke parë unitetin tuaj dhe përkushtimin në procesin mësimor dhe në gjithë angazhimet sindikale. Si menaxher për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm në koordinim të angazhimeve me stafin dhe me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve u angazhuam pa shikuar orarin e punës e madje edhe duke i kthyer në ditë pune vikendet bashkë me shumë kolege e kolegë arritëm të realizojmë e madje të tejkalojmë objektivat e trajnimeve, por realizuam edhe shumë aktivitete të tjera. Kështu do të vazhdojmë edhe në të ardhmen. Gëzuar, shëndet të mirë e shumë suksese e arritje për ju e familjet tuaja të nderuara!



Afërdita Ahmeti

Duke u angazhuar në shërbim të anëtarësisë u krijua atmosferë pune e përkushtimi dhe stafi qendror për ne është familja e dytë. Jemi munduar të kryejmë detyrat tona me qëllim që kërkesat tuaja të realizohen në kohën më të shkurtër të mundshme. Entuziazmin për angazhime edhe kur përballeshim me shumë sfida e gjeta te përkrahja e kolegëve të mi dhe të respektit tuaj për ne. Anëtarësi e nderuar kudo jeni paçi fat e suksese të shumta e shëndet të mirë. Gëzuar!



Nezafete Jakupi

Është nder e krenari të jesh pjesë e stafit qendror e me këtë edhe anëtare e SBASHK-ut. Në një atmosferë pune e përkushtimi në shërbim të anëtarësisë po kalojmë edhe vitin 2021, që solli shumë sfida, por bashkë me ju arritëm të realizojmë shumë aktivitete sindikale duke dëshmuar unitet e arritje të vazhdueshme. Ne do të vazhdojmë me përkushtimin sepse besimi juaj është forcë për ne. Me angazhime e suksese të reja edhe në vitin 2022 Gëzuar, fat, jetë të lumtur e realizim të dëshirave për ju kudo jeni anëtarësi e nderuar e SBASHK-ut !



Blendor Shatri

Edhe në vitin 2021 jemi mundur i gjithë stafi që të jemi në shërbim të realizimit të kresave të anëtarësisë dhe besoj se falë angazhimit të koordinorit për organizim të

detyrave dhe kemi realizuar shumë nga kërkesat tuaja anëtarësi e nderuar. Kështu do të vardojmë edhe në vitet në vijim dhe me unitetin e mbështetjen tuaj do të arrijmë suksesshëm të përballemi me sfidat e kohës. Gëzuar dhe fat e shumë suksese edhe në vitin 2022.



Vlora Rexhepi Berisha

Viti 2021 ishte i vështirë e me plot sfida për arsimin në Kosovë e kudo në botë. Uniteti dhe angazhimi i përbashkët ka bërë që të përballemi suksesshëm me sfidat dhe të arrijmë suksese të shumta. Përfaqësuesit e SBASHK-ut në mënyrë të dinjitetshme përfaqësuan

sindikatat tonë edhe në takimet e aktivitetet e shumta ndërkombëtare organizuar nga ETUCE e EI. Kështu do të vazhdojmë bashkërisht edhe në vitin 2022, por edhe në vitet tjera.

Fat e shëndet të mirë për ju dhe familjet tuaja të nderuara. Gëzuar !



Albina Arifi

Përsëritet anëtarësi e nderuar e SBASHK-ut kudo jeni. Me shumë prej jush isha vazhdimisht në komunikim përmes organizimit dhe rrjedhës së mbarë të trajnimeve të

shumta, që janë organizuar gjatë gjithë vitit 2021. Kemi krijuar besim dhe respekt të ndërsjellë dhe këtë edhe do ta ruajmë. Unë kam fatin që jam pjesë e një stafi të mrekullueshëm, të cilët kurdo herë ishte e nevojshme më ndihmuan me qëllim që trajnimet të organizohen me kohë dhe të kenë rrjedhë të mbarë. Falënderoj për përkrahjen koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, por edhe Afërditën, Blendin, Nezin, Vlorën dhe nënkryetaren Vjollca që më përkrahën e më dhanë kurajë kur kishim të bënim më shumë të madh trajnimesh dhe kjo më dha

të anëtarësisë. Gëzuar.

Rrahman Jasharaj



Të nderuara anëtare dhe anëtarë të SBASHK-ut po përmbyllem edhe një vit, që ishte me sfida të mëdha. Pandemia vazhdojë të godas kudo te ne e në botë dhe arsimi po frymonte me vështirësi, por ju, si në të kaluarën edhe tani e gjithmonë, u dëshmuat se jeni në krye të misionit të shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave. JU falënderoj edhe për unitetin e dëshmuar dhe për përkrahjen ndaj stafit qendror dhe ndaj meje. Ju premtoj se do të vazhdojmë me angazhimet dhe përkushtimin për realizimin e kërkesave tuaja edhe në të ardhmen. Gëzuar. Bashkë e në SBASHK.



Vjollca Shala

Në përmbyllje të këtij viti është bërë edhe vlerësimi i arritjeve të SBASHK-ut. U vlerësua se edhe përkundër vështirësive, me angazhimin maksimal të stafit qendror dhe të veprimtarëve të shumtë sindikalë janë shënuar suksese e arritje të shumta. Ne bashkë me ju do të vazhdojmë

këtë rrugëtim duke qenë në krye të detyrave tona e në shërbim të realizimit të kërkesave legjitime. Gëzuar! Fat e suksese të shumta edhe në vitin 2022.

Gjatë muajit

ETUCE dhe EPSU në mbrojtje të pavarësisë së sindikatave

Miliona sindikalistë nga Evropa në mbështetje të SBASHK-ut

Duke përcjellë me kujdes situatën aktuale në arsimin e Kosovës dhe angazhimet e vazhdueshme të SBASHK-ut për dialog e për zgjedhje të drejtë të kresave legjitimet të anëtarësisë dhe duke parë qëndrimet jo të drejta të Kryeministrit Kurti dhe deklaratimet e tij që janë përzierje e pa drejtë në pavarësinë dhe organizimin e sindikatave Kryetari i EUCE Larry Flanagan, drejtorja Evropiane e ETUCE-së Susan Flocken dhe sekretari i përgjithësim i ESPU Jan Willem Goudriaan, i kishin dërguar më 9 dhjetor një letër të përbashkët Kryeministrit Kurti duke ia bërë me dije se vlerësojë lart angazhimin e SBASHK-ut dhe duke kërkuar që Kryeministri të nis dialogun e sinqertë dhe të heq dorë nga praktika e gabuar për përzierje në organizimin sindikalë dhe në të drejtën e patjetërsueshme të anëtarësisë që të vendos me votën e lirë se kush do të udhëheq sindikatë e tyre. Kryeministri Kurti i ishte përgjigjur atyre me një letër të datës 18 dhjetor, por përmbajtja e saj ishte vazhdimësi e tendencës për prierje në organizimin dhe aktivitetin si sindikal të SBASHK-ut dhe të Federatës së Sindikatës së Shëndetësisë. Kjo ka bërë që ETUCE dhe EPSU të vazhdojnë me angazhimet në mbështetje të këtyre dy sindikatave dhe për këtë i kanë dërguar letër Komisionarit të BE-së, z. Schmit.

SBASHK-u sot mori një informatë nga Komiteti i Sindikatave Evropiane të Arsimit (ETUCE) dhe nga Unioni Evropian i Sindikatave të Shërbimeve Publike (EPSU) të nënshkruar nga kryetari i EUCE Larry Flanagan, drejtorja Evropiane e ETUCE-së Susan Flocken dhe sekretari i përgjithësim i ESPU Jan Willem Goudriaan, nga e cila ne kuptuam se Kryeministri Albin Kurti u është përgjigjur në shkresën e tyre që i kishin dërguar më 9 dhjetor 2021. Kuptuam nga kjo letër se ETUCE dhe ESPU janë të pakënaqur e të indinjuar me përgjigjen e Kryeministrit dhe duke parë se Kryeministri Kurti vazhdon të ketë qasje të gabuar ndaj sindikatave dhe vazhdon të tentojë të përzihet edhe në zgjedhjet e udhëheqësve në SBASHK dhe në FSSHK, i kanë dërguar letër Komisionarit të Bashkimit Evropian për Punë dhe Drejtësi Sociale, Nicolas Schmit që ai të ngrit këtë çështje dhe të marr hapa konkret bazuar në kompetencat që ka.



To: Commissioner Schmitt



Brussels, 21 December 2021

Subject: ETUCE and EPSU support with trade unions in Kosovo

Dear Commissioner Schmitt,

With this letter, the European Trade Union Committee for Education (ETUCE), representing 127 education trade unions i.e., more than 11 million members across Europe, together with the European Public Service Union (EPSU) representing 260 trade unions in health and social care, public administrations, utilities and municipal services and millions of public service workers express their robust support and solidarity with their member organisation, Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK) and Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) and share their indignation over Kosovar government representatives' arbitrary interference in trade union matters.

We deem it entirely unacceptable that, in the press conference of 5 December 2021, the Kosovar government demanded the replacement of trade union leaders in the health sector. Such statements along with the adverse tendency of interfering into trade union election processes, including in the education sector, is an absolute infringement and grave violation of European and international laws.

It is scandalous that in reply to our joint letter in which EPSU and ETUCE expressed their full support with their trade unions and raised concern about the interference of the government in internal trade union issues and jeopardising core trade union rights, the Prime Minister, Mr. Albin Kurti, categorises the call of the unions to strike as "a disrespect of administrative procedures and a threat to the citizens". He even goes as far as to voice his discontent with the trade union leadership in the health and education sector, stating that the "current leaders of these unions does not reflect the true democratic will of their members, rather, they were installed by corrupt, neoliberal governments of the past".

We stress that trade union activities and decision-making process must be free from any interference from state bodies or any other parties and must be in line with their internal rules and procedures exclusively.

ETUCE and EPSU recall, that as a signatory of the [Stabilisation and Association Agreement between the EU and Kosovo](#), and in light of Kosovo potential candidate country status to the EU, it is fundamental

that the Kosovar government demonstrates in practice both the commitment and promotion of democratic aspirations that lay the very foundation of the EU. The adherence to the EU and its core values, principles, and standards should be reflected, both through legal and symbolic settings.

In addition, as stipulated in the Article 106 of the Stabilisation and Association Agreement (SAA) with Kosovo, the cooperation of the signatory parties shall seek, among other things, to promote social dialogue. The detrimental practices of interfering in trade union matters and apparent suspension of social dialogue processes totally contradict with the ongoing [EU Social Agenda](#) and in particular with the principle 8 of the European Pillar of Social Rights that pursues support for increased capacity of social partners to promote social dialogue.

ETUCE and EPSU strongly denounce any attempts of governments to intervene into internal trade unions' functioning and the lack of social dialogue, we therefore wish to bring this issue to your attention and call on the European Commission to take action accordingly, not at least in the wake of the 4th meeting of the Stabilisation and Association Council between the European Union and Kosovo¹, Brussels, 7 December 2021. Indeed, we propose that the European Commission facilitates a mission with the ILO even though the country is not a member yet. We are also available to discuss with you and your services how the importance of autonomous social partners and effective social dialogue and negotiations in the public sector can be promoted in the country and with the government.

We look forward to hearing from you on this important matter.

In solidarity,

Susan Flocken
ETUCE European Director

Larry Flanagan
ETUCE President

Jan Willem Goudriaan
EPSU General Secretary

¹ This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.

Kjo është përmbajtja e letrës së dërguar nga kryetari i EUCE Larry Flanagan, drejtorja e përgjithshme Susan Flocken dhe sekretari i përgjithshëm i EPSU Jan Willem Goudriaan Komisionarit Bashkimit Evropian për Punë dhe Drejtësi Sociale, Nicolas Schmit:

Tema: Mbështetja e ETUCE dhe EPSU me sindikatat në Kosovë

I nderuar Komisioner Schmit

Me këtë letër, Komiteti i Sindikatave Evropiane për Arsimin (ETUCE), që përfaqëson 127 sindikata të arsimit, dmth, më shumë se 11 milionë anëtarë në të gjithë Evropën, së bashku me Unionin Evropian të Shërbimit Publik (EPSU) që përfaqëson 260 sindikata në shëndetësi dhe kujdes social, administratat publike, shërbimet komunale dhe miliona punëtorë të shërbimeve publike shprehin mbështetjen dhe solidaritetin e tyre të fuqishëm me organizatën e tyre anëtare, Sindikatën e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK) dhe Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) dhe ndajnë indinjatë për ndërhyrjen arbitrare të përfaqësuesve të qeverisë kosovare në çështjet e sindikatave. Ne e konsiderojmë krejtësisht të papranueshme që në konferencën për media të datës 5 dhjetor 2021, qeveria e Kosovës kërkoi zëvendësimin e drejtuesve sindikalë në sektorin e shëndetësisë. Deklarata të tilla së bashku me tendencën e pafavorshme për të ndërhyrë në proceset zgjedhore sindikaliste, përfshirë edhe atë të arsimit, është shkelje absolute dhe shkelje e rëndë e ligjeve evropiane dhe ndërkombëtare.

Është skandaloze që në përgjigje të letrës sonë të përbashkët në të cilën EPSU dhe ETUCE shprehën mbështetjen e tyre të plotë me sindikatat e tyre dhe ngritën shqetësimin për ndërhyrjen e qeverisë në çështjet e brendshme sindikale dhe rrezikimin e të drejtave thelbësore sindikaliste, Kryeministri z.Albin Kurti, thirrjen e sindikatave për grevë e kategorizon si "mosrespektim të procedurave administrative dhe kërcënim për qytetarët". Madje ai shkon deri aty sa shpreh pakënaqësinë e tij me lidhshimin sindikal në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit, duke thënë se "drejtuesit aktualë të këtyre sindikatave nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë demokratik të anëtarëve të tyre, përkundrazi, ata janë instaluar nga qeveritë e korruptuara, neoliberale të së shkuarës".

Theksojmë se aktivitetet sindikale dhe procesi i vendimmarrjes duhet të jenë të lira nga çdo ndërhyrje

nga organet shtetërore apo palët e tjera dhe duhet të jenë ekskluzivisht në përputhje me rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme.

ETUCE dhe EPSU rikujtojnë se si nënshkruese e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, dhe në dritën e statusit të Kosovës si vend kandidat i mundshëm në BE, është thelbësore që qeveria e Kosovës të demonstrojë në praktikë edhe përkushtimin dhe promovimin e aspiratave demokratike që vendosin vetë themelin e BE-së. Aderimi ndaj BE-së dhe vlerave, parimeve dhe standardeve të saj thelbësore duhet të reflektohet, si përmes mjediseve ligjore ashtu edhe atyre simbolike.

Përveç kësaj, siç përcaktohet në nenin 106 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me Kosovën, bashkëpunimi i palëve nënshkruese do të synojë, ndër të tjera, të promovojë dialogun social. Praktikën e dëmshme të ndërhyrjes në çështjet e sindikatave dhe pezullimi i dukshëm i proceseve të dialogut social kundërshtojnë plotësisht Agjendën Sociale të BE-së në vazhdim dhe në veçanti me parimin 8 të Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale që ndjek mbështetjen për rritjen e kapaciteteve të partnerëve social për të promovuar dialogun social. ETUCE dhe EPSU denoncojnë fort çdo përpjekje të qeverive për të ndërhyrë në funksionimin e sindikatave të brendshme dhe mungesën e dialogut social, prandaj dëshirojmë t'ua sjellim këtë çështje në vëmendjen tuaj dhe i bëjmë thirrje Komisionit Evropian që të ndërmarrë veprime në përputhje me rrethanat, jo të paktën në vazhdim të takimit të katërt të Këshillit të Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës¹, në Bruksel, 7 dhjetor 2021. Në të vërtetë, ne propozojmë që Komisioni Evropian të fasilitoj një mision me ILO-në edhe pse vendi nuk është ende anëtar. Ne jemi gjithashtu në dispozicion për të diskutuar me ju dhe shërbimet tuaja se si mund të promovohet në vend dhe me qeverinë rëndësia e partnerëve social autonomë dhe dialogu e negociatat sociale efektive në sektorin publik. Mezi presim të dëgjojmë nga ju për këtë çështje të rëndësishme.

Në solidaritet,

Susan Flocken, Drejtore evropiane e ETUCE

Larry Flanagan, Kryetar i ETUCE

Jan Willem Goudriaan, Sekretar Gjeneral i EPSU

SBASHK shembull i shkëlqyer i gatishmërisë për dialog

Takime me shefat e Grupeve Parlamentare kanë vazhduar

Me qëllim që t'i informojnë subjektet politike që janë pjesë e Parlamentit të Kosovës, SBASHK-u u kishte dërguar shefave të Grupeve Parlamentare shkresa me kërkesën për takime me ta. Duke realizuar këtë aktivitet SBASHK bashkë me përfaqësuesin e BSPK-së dhe të Federatave mori pjesë fillimisht në një tryezë organizuar nga shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, z. Besnik Tahiri, e në të cilën tryezë po merrte pjesë edhe kryetari i këtij subjekti politik Ramush Haradinaj. Pas prezantimit të idesë së kësaj tryeze e që kishte të bënte me Ligjin e pagave dhe fjalëve hyrëse të z. Tahiri e z. Haradinaj, në emër të BSPK-së qëndrimet dhe angazhimet i shpalosi Ymer Ymeri, i autorizuar nga kryetari i kësaj Konfederate, Atdhe Hykolli e pas kësaj qëndrimet dhe kërkesat e anëtarësisë i kanë prezantuar kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe kryetarët e federatave të tjera.

SBASHK ka vazhduar në ditët në vijim takimet edhe me shefat e Grupeve tjera Parlamentare për t'u takuar me shefen e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje Mimoza Kusari-Lila. Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë takim shprehën kërkesat e anëtarësisë dhe shprehën kritika për mungesën e gatishmërisë së Qeverisë për takime e dialog.



Ata u shprehën se presin nga znj. Lila që të angazhohet dhe të mundësojë dialogun dhe bashkë me deputetët e këtij subjekti politik të angazhohen që në Ligjin për buxhet të parashihen mjete edhe për Ligjin e pagave. Në vazhden e realizimit të kësaj agjende

përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar edhe me shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Abelard Tahiri dhe deputeten nga ky subjekt politik, që është edhe anëtare e Komisionit parlamentar për arsim, znj. Eliza Hoxha.

SBASHK-u është përfaqësuar në këtë takim nga kryetari Rahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, të cilët, ashtu si në takimet tjera me shefat e Grupeve Parlamentare, kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me fatin e Ligjit të pagave duke kërkuar që deputetët nga subjektet politike bashkë me kolegët e tyre nga subjektet tjera politike të angazhohen që në Ligjin për buxhet të planifikohet buxhet që do të mundësonte implementimin e Ligjit të pagave.



Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri është shprehur se kupton shqetësimet e anëtarësisë së SBASHK-ut duke premtuar se do të angazhohen maksimalisht që në debatin parlamentar të japin kontribut bashkë me subjektet tjera politike që të krijohet mbështetje buxhetore për Ligjin pagave dhe të shtohen angazhimet që ky Ligj të përgatitet dhe në kohën më të shkurtër të mundshme të nis së implementuari. Deputetja dhe anëtarja e Komisionit parlamentar për arsim, znj. Eliza Hoxha ka shprehur gatishmërinë që të organizohen takime në këtë Komision dhe të bashkëbisedohet për gjithë çështjet në arsim duke bërë angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit dhe ngritjes së vazhdueshme të cilësisë.

Në përmbyllje të agjendës së zgjedhjeve të brendshme në SBASHK

U mbajt Kuvendi i Arsimit Parafillor, Fillor e të Mesëm të Ulët

Duke vazhduar me realizimin e agjendës së zgjedhjeve në vitin zgjedhor të SBASHK-ut më 11 dhjetor në sallën e takimeve të Qendrës së studentëve është mbajtur Kuvendi i Arsimit Parafillor, Fillor e të Mesëm të Ulët.



Në fillim të takimit Kryetari i këtij Kuvendi Blerim Mehmeti ka falënderuar delegatët për pjesëmarrje duke përshëndetur në emër të tyre kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe nënkryetaren Vjollca Shala. Pas kësaj ai ka prezantuar rendin e punës, që është aprovuar njëzëri. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar gjithë delegatët e pranishëm, por edhe kolegët e koleget kudo janë në Kosovë për punën e përkushtimin duke kujtuar se punëtorët e arsimit u dëshmuar në misionin e tyre të shenjtë edhe në vitet e okupimit duke mbrojtur arsimin shqip dhe duke kultivuar e ruajtur shpresën për Kosovën e lirë e të pavarur. Ai ka shtuar se edhe në këto vite kur pandemia po krijon probleme të shumta kudo në botë punëtorët e arsimit prapë u dëshmuar duke mbrojtur arsimin shqip nga një armik tjetër, që është tinëzar dhe ka rrëmbyer edhe shumë kolege e kolegë.



Kryetari Jasharaj ka lavdëruar pastaj edhe angazhimet e vazhdueshme të kryetarit të Kuvendit të Arsimit Parafillor, Fillor e të Mesëm të Ulët, Blerim Mehmeti për të cilin ka veçuar se gjithmonë është angazhuar dhe ka prezantuar në takime të shumta në SBASHK, por edhe në institucione zërin, jo vetëm të këtij niveli arsimor, por edhe të SBASHK-ut në tërësi.

Pas kësaj Komisioni zgjedhor ka filluar me procesin zgjedhor duke pranuar fillimisht propozimet për të gjithë pozitat udhëheqëse të këtij Kuvendi.



Në një garë mes dy e më shumë kandidatëve e përmes votës së lirë kryetar është rizgjedhur Blerim Mehmeti kurse nënkryetare Lutfie Ibrahim. U zgjodh edhe kryesia nga të kandiduarit nga të gjitha pjesët e Kosovës. Kryesia e re ka këtë përbërje: Shqipe Zeneli, Arif Elezaj, Burim Beka, Hyrie Hoti, Shpresa Musa, Besim Kryeziu dhe Blerina Haraçija. Kryetari Mehmeti në fjalën përmbyllëse falënderoi të gjithë të pranishmit për besimin e dhënë duke premtuar se bashkë me kryesinë do të angazhohen edhe në të ardhmen për të prezantuar në mënyrë të denjë kërkesat dhe zërin e anëtarësisë e duke dhënë kontribut për ruajtjen e unitetit në SBASHK.

U mbajt Kuvendi i Arsimit të Mesëm të Lartë Viti 2021, vit zgjedhor i SBASHK-ut

Në sallën e takimeve në Qendrën e Studentëve më 14 dhjetor u mbajt Kuvendi i Arsimit të Mesëm të Lartë. Në mungesë të kryetarit të Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë, takimin e hapi dhe e drejtoj nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala e cila përshëndeti delegatët e pranishëm dhe i përgëzoi për punën dhe përkushtimin e tyre, e në veçanti shprehi falënderim dhe respekt për kryetarin e SAMK Rexhep Sadiku dhe kryesinë e SAMK. Rexhep Sadiku është angazhuar dhe ka prezantuar arsimin e mesëm të lartë në takimet e SBASHK-ut dhe ka dhënë një kontribut të çmuar.



Më pastaj nënkryetarja prezantoi rendin e punës të cilin e aprovuan unanimisht delegatët. Në takim ishte edhe koordinatori për organizim të brendshëm të SBASHK -ut Ymer Ymeri i cili ka dhënë sqarime lidhur me procesin e zgjedhjeve duke dhënë kontribut që Statuti të respektohet në tërësi dhe që procesi i zgjedhjes të ketë rrjedhë të mbarë. Në vazhdim të takimit delegatët kanë zgjedhur komisionin zgjedhor. Komisioni zgjedhor më pastaj ka filluar me procesin zgjedhor duke pranuar fillimisht propozimet për të gjithë pozitat udhëheqëse të këtij Kuvendi.



Në një garë mes dy kandidateve përmes votës së lirë kryetare është zgjedhur Hanife Salihu kurse nënkryetar Kemajl Bislmi. U zgjodh edhe kryesia e SAMK që përfshin të gjitha regionet e Kosovës. Kryesia e SAMK është në këtë përbërje: Valbona Kryeziu, Arta Haxhimehmeti, Shkurte Berisha, Ganimet Mrasori, Fevziye Tafili Berisha, Emerlla Zejnullahu dhe Vlora Bejtullahu.




Kryetarja Salihu në fjalën e saj përmbyllëse falënderoj të gjithë të pranishmit për besimin e dhënë duke premtuar se bashkë me kryesinë do të angazhohen për të prezantuar në mënyrë të denjë kërkesat dhe zërin e anëtarësisë e duke dhënë kontribut për ruajtjen e unitetit në SBASHK.



Në takimin e kuvendit të arsimit të mesëm të lartë u dëshmuar uniteti dhe mbështetja e fuqishme për SBASHK-un.

Takim i Kryetarëve të nivelit komunal dhe të Universiteteve **Mbështeten vendimet nga takimi i BSPK-së me Federatat**

Takimi i përfaqësues të SBASHK-ut me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike Sfeçla kishte krijuar shkëndijat e para të shpresës së më në fund, po fillon dialogu mes sindikatës sonë dhe institucioneve. Për ta bashkëbiseduar këtë moment të ri dhe për të marrë vendim për angazhimet e veprimet e radhës SBASHK-u organizoi një takim nga larg me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të Universiteteve për të debatuar për situatën aktuale dhe për të marrë vendim për angazhimet dhe veprimet e radhës.



Kryetari i SBASHK-ut ka raportuar për angazhimet e bëra në nivelin qendror që të niset me dialogun dhe që të dihet fati i Ligjit të pagave duke përmendur edhe takimin me Ministrin Sfeçla dhe Ministren Nagavci, por edhe duke treguar se në takimin e jashtëzakonshëm të BSPK-së me Federatat anëtare të kësaj Konfederate përfaqësuesit e Federatave janë pajtuar që të autorizojnë kryetarin e BSPK-së që të kërkojë takim me Kryeministrin Kurti për të kërkuar që në bashkëpunim me sindikata të punohet urgjentisht në Ligjin pagave, në Ligjin për sigurimet shëndetësore dhe të këtë ndryshime në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, me qëllim që të hiqet kushtëzimi prej 15 vite përvojë pune para viteve të 90-ta dhe të gjendet një formë e pranueshme lidhur me këtë çështje.

Nga kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të Universiteteve u vlerësua se është arritur të realizohet kërkesa e SBASHK-ut për nisje të dialogut me

Qeverinë dhe kërkesa që të dihet lidhur me fatin e ligjit të pagave dhe me vendim unanim u përkrahen vendimet e BSPK-së për angazhim dhe për t'i dhënë kohë Qeverisë që ta punojë ashtu si duhet e pa defekte versionin e parë të Ligjit të pagave dhe pas kësaj në kohën më të shkurtër të mundshme, e se largu në fillim të marsit të nisnin takimet me sindikatat dhe pas kësaj deri në fund të muajit mars të përgatitet versioni final e të dërgohet në Qeveri për votim dhe të vazhdohet me procedurat parlamentare.



Duke i dhënë rëndësi bashkëpunimit korrekt me Këshillat e prindërve është mbajtur takimi i radhës me Këshillin e Prindërve të Prishtinës, të cilët SBASHK i ka falënderuar për bashkëpunimin dhe angazhimin e përbashkët që me dialog të gjenden zgjidhje të pranueshme për kërkesat legjitime të anëtarësisë së SBASHK-ut. Ata janë njoftuar për vendimet që janë marrë në takimin e BSPK-së me federatat dhe për takimin nga larg me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve.



BSPK-ja bashkë me federatat do të përcjell nga afër angazhimet e Qeverisë lidhur me këto tri çështje dhe nëse vëren se ka ngecje dhe vonesa, atëherë do të shpall veprime sindikale, që do të vlejné për të gjitha Federatat anëtare. Përfaqësuesit e Këshillit të

Prindërve i janë gëzuar kësaj informate dhe kanë inkurajuar SBASHK-un që të vazhdojë me përpjekjet që me dialog të arrihet deri të zgjidhja e kërkesave legjitime të anëtarësisë.

Kuvendi Zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar i Shtërpcës

Kryetar i ri u zgjodh Bektesh Bajrami

Në ambientet e shkollës "Osman Mani" të fshatit Firajë, të komunës së Shtërpcës u mbajt Kuvendi Zgjedhor i sindikatës së arsimit parauniversitar për këtë komunë.

Para fillimit të këtij kuvendi, drejtorja e këtij institucioni arsimor Ganimete Xhemajli u takua me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri, të cilëve u ka dëshiruar mirëseardhje dhe ka shprehur gjithë respektin për angazhimet e mëdha të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

Ajo ka treguar edhe për historikun e kësaj shkolle, që nëpër vite e dekada dha kontribut të çmuar në edukimin dhe arsimimin e brezave.

Kryetari i SBASHK-ut Jasharaj ka përgëzuar gjithë kolegët e kësaj komune duke veçuar se ata e kishin edhe më vështirë se edhe ne të tjerët ngase punuan e po punojné në specifika të tjera dhe me plotë sfida.

Zyrtari ligjor i SBASHK-ut Shatri ka dhënë gjithë sqarimet e duhura të bazuara në statut për rrjedhë të mbarë të zgjedhjeve.



Pas kësaj komisionit zgjedhor të pranishmit i kanë propozuar dy e më shumë kandidatë për kryetar, nënkryetar dhe funksionet tjera sindikale. Me votën e lirë e të fshehtë kryetar u zgjodh Bektesh Bajrami, ndërsa nënkryetare Hyra Ymeri. Është zgjedhur edhe kryesia, delegati për kongresin e SBASHK-ut dhe anëtari për Këshillin Drejtues.

Pas kësaj, ka filluar kuvendi zgjedhor dhe kryetari i deritashëm Hamdi Aliu ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar duke nënvizuar se falë angazhimit dhe unitetit edhe në këtë komunë të vogël janë parë aktivitete të SBASHK-ut dhe kjo ka bërë që të shtohen vazhdimisht radhët me anëtarë të ri.

Kryetari i ri Bajrami u zotua se do të vazhdojë angazhimet në shërbim të anëtarësisë duke pasur përkrahjen e nivelit qendror.

Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Dragash

Kryetar i ri u zgjodh Vloran Krasniqi

Në ambientet e Shkollës "Samidin Emini" të fshatit Kuk të Dragashit u mbajt Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë.

Duke hapur punimet e këtij Kuvendi kryetari Xhevit Skenderi ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri. Pas kësaj ai ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar për katër vitet e shkuara. Duke shpalosur punën dhe përkushtimin në nivel komunal e duke lavdëruar përkushtimin e dëshmuar nëpër vite të stafit qendror ai ka theksuar se dikur në Dragash kishte numër të vogël të anëtarësisë, por ai numër është shtuar vazhdimisht dhe kjo tregon se SBASHK-u ka arritur të krijoj besim duke realizuar kërkesat e anëtarësisë e duke qenë vazhdimisht në shërbim të tyre.



Kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur të pranishmit dhe ka falënderuar edhe drejtorin e shkollës për

mikpritjen. Pas kësaj kryetari Jasharaj është shprehur me respekt për kolegun Xhevit Skenderi, i cili ka treguar vazhdimisht përkushtim në realizimin e kërkesave të anëtarësisë duke shprehur keqardhje pse ai për arsye shëndetësore nuk po kandidon edhe për një mandat për të vazhduar me angazhimin dhe kontributin e lartë në realizimin e misionit tonë sindikal.

Pas kësaj zyrtari ligjor Blendor Shatri ka kujtuar pjesë nga Statuti i SBASHK-ut që kanë të bëjnë me rrjedhën e zgjedhjeve të nivelit komunal. Procesi zgjedhor ka nisur me propozimin e kandidatëve për kryetarin dhe pozitat tjera udhëheqëse të këtij Kuvendi. Përmes votës së lirë e të fshehtë kryetar i ri është zgjedhur Vloran Krasniqi. Janë zgjedhur me votën e fshehtë edhe anëtarët e kryesisë, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut dhe përfaqësuesi i këtij Kuvendi në Këshillin Drejtues.



Në mbyllje të këtij takimi anëtarët e këtij Kuvendi kanë propozuar Rahman Jasharajn, që edhe për një mandat të jetë kryetar i SBASHK-ut.

Edhe një marrëveshje e SBASHK me institucione shëndetësore

Në laboratorin "Mrika" në Vushtrri analizat me zbritje 15 %

Duke shprehur respekt meritore për angazhimet e SBASHK-ut dhe për punëtorët e arsimit që janë anëtarë të sindikatës sonë Laboratori "Mrika" në Vushtrri në një ceremoni solemne ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë,

Alush Maloku e përmes tij kjo marrëveshje është nënshkruar edhe nga kryetari i SBASHK-ut.

Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Vushtrrisë, Alush Maloku i është falënderuar stafit udhëheqës dhe atij

mjekësor të këtij institucioni shëndetësor duke e konsideruar këtë marrëveshje në shërbim të anëtarësisë si shprehje e respektit të këtyre mantelbardhëve për punën dhe përkushtimin e punëtorëve të arsimit.

Kjo marrëveshje saktëson se të gjitha shërbimet laboratorike të biokimisë klinike – hematologjike që do të kryejnë anëtarët e SBASHK-ut në këtë institucion mjekësor, do jenë me zbritje prej 15 %, ndërsa për anëtarët e familjes së ngushtë të tyre zbritje prej 10%.

Këtë marrëveshje e ka nënshkruar edhe kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj duke shprehur respekt meritore për këtë veprim të Laboratorit "Mrika", që

duke bërë këtë marrëveshje për zbritje çmimesh të shërbimeve laboratorike tregon respektin për pishtarët e dijes.



Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Universiteteve dhe Shkencës të Kosovës (SUSHK)

Kryetar u rizgjodh Bardh Bardhi, ndërsa nënkryetare u zgjodh Sinavere Ukshini

Sindikata e Universiteteve dhe Shkencës e Kosovës, e cila është njëra nga shtyllat e SBASHK-ut, pas kryerjes me sukses të zgjedhjeve nëpër shoqata sindikale dhe në Kuvendet e të 7 Universiteteve, ka mbajtur Kuvendin zgjedhor në Amfiteatrin "Idriz Ajeti" të Fakultetit filologjik.



Në hapje të këtij Kuvendi kryetari Bardh Bardhi ka përshëndetur pjesëmarrësit, që po përfaqësonin Fakultetet e Kosovës dhe në emër të tyre ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri. Pas kësaj kryetari Bardhi ka prezantuar raportin e

punës dhe atë financiar për katër vitet e kaluara, të cilët në formë të shkruar ua kishte dërguar me kohë gjithë pjesëmarrësve të këtij Kuvendi. Ai pastaj është ndalur në momente të veçanta të aktivitetit të SUSHK në kuadër të SBASHK-ut e duke veçuar faktin se pas angazhimeve të mëdha e në mbështetje të fuqishme të stafit qendror të SBASHK-ut u arrit që edhe Universitetet të jenë të përfshirë në Kontratën e Arsimit të Kosovës e me këtë u krijuan mundësitë që anëtarët e SBASHK-ut, të punësuar në këto institucione e të arsimit të lartë të gëzojnë gjithë mbrojtjen, por edhe benefitet sikur edhe sindikalistët tjerë të arsimit të Kosovës. Ai ka kujtuar edhe aktivitete e arritje të tjera duke vlerësuar lart edhe kontributin e kryetarit Jasharaj dhe gjithë stafit qendror.

Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj në fjalën e tij përshëndetëse ka përgëzuar përfaqësuesit e gjithë Universiteteve për punën dhe angazhimet si dhe për unitetin e treguar përball sfidave të shumta të kohës. Ai ka shtuar se për të ka qenë nder e krenari që të

angazhohet bashkë me Bardh Bardhin, i cili ka prezantuar në mënyrë të denjë kërkesat e anëtarësisë nga të gjithë Universitetet dhe ka dhënë kontribut me vlerë edhe në të shumë nga angazhimet në nivel qendror. Kryetari Jasharaj ka përshëndetur dhe ka falënderuar edhe prof. dr. Azem Kyçyku, i cili ishte pjesë e këtij takimi, për përkushtimin dhe kontributin e tij në angazhimet e SBASHK-ut.



Pas kësaj Komisioni zgjedhor ka nisur me procesin e kandidimeve e pastaj edhe të votimit për organet udhëheqëse të SUSHK, për Komisionin mbikëqyrës dhe për delegatët e Kongresit e për përfaqësuesit e Universiteteve në Këshillin Drejtues.



Në një garë të fortë e mes 2 e më shumë kandidatëve kryetar u rizgjodh Bardh Bardhi, kurse nënkryetare Sinavere Ukshini. U zgjodhën po ashtu me votën e fshehtë e të lirë edhe 9 anëtarë të kryesisë: Afrim Qela, Abedin Sadriu, Bekë Kuqi, Besa Rexhepi, Flutura Demaku, Refik Ibrahim, Përparim Avdullahu, Arta Zabërgja dhe Veli Kryeziu. Po me votën e lirë e të fshehtë u zgjodhën edhe delegatët për kongresin e SBASHK-ut dhe përfaqësuesit e SUSHK –ut në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

